



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,

Në bazë të neneve 3.1, 3.4, 15.1 pikat (a), (c), (e), (f), (j), 21.2, 78, 79, 80 pikat (c) të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Viti III, Nr 28, 4 qershor 2008),

Me qëllim të rregullimit të ofrimit të Shërbimeve Meteorologjike në Republikën e Kosovës në përputhje me standardet dhe praktikat e rekomanduara të përcaktuara në Aneksin 3 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar,

Pasi ka përfunduar procesin e konsultimit publik me të gjitha palët e interesuara në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr. 01/2012 për konsultimin publik të palëve të interesuara,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE NR.2/2014 PËR ZBATIMIN E ANEKSIT 3 NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE MBI AVIACIONIN CIVIL PËR SHËRBIME METEOROLOGJIKE

Neni 1

Fusha e zbatimit

1.1 Kjo Rregullore përcakton kërkesat për ofrimin e Shërbimeve Meteorologjike (ShM), në përputhje me Standardet dhe Praktikët e Rekomanduara (SPR) përkatëse të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ONAC), të përcaktuara në Aneksin 3 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar.

1.2 Ofrimi i Shërbimeve Meteorologjike (ShM) në Republikën e Kosovës, do të qeveriset nga SPR të Aneksit 3 dhe Shtojcat 1-10, Shtesat A, B, C dhe D të publikuara në Botimin korrik 2010 nga ONAC.

Neni 2

Zbatimi i SPR-ve

2.1 Aneksi 3 mbi Shërbimet Meteorologjike (ShM), siç është përcaktuar sipas nenit 1 paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje do të jenë të zbatueshme në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

2.2 SPR të zbatueshme të specifikuara në Aneksin 3 (ShM) si dhe Shtojcat dhe shtesat e saj do të jenë të zbatueshme në Republikën e Kosovës, përveç nëse dispozitat e nenit 4 të kësaj Rregulloreje tregojnë ndryshe.

Neni 3

Termat dhe Përkufizimet

3.1 Për qëllim të kësaj Rregulloreje termat “Shtet Kontraktues”, “Shteti” drejtpërdrejtë ose tërthorazi të përdorura në njëjës apo në shumës në Aneksin 3 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, siç përcaktohet më sipër në nenin 1, paragrafi 2, do të lexohen si “Republika e Kosovës”.

3.2 Dallimet e listuara në nenin 4 të kësaj Rregulloreje në kuptim të kësaj Rregulloreje nënkuptojnë qoftë shmangien nga standardi ose ngritjen e një praktike të rekomanduar në nivelin e standardit.

Neni 4

Dallimet nga SPR-të

4.1 Dallimet e zbatueshme nga SPR-të e Aneksit 3 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar siç është specifikuar në nenin 1, paragrafi 2 i kësaj Rregulloreje janë listuar sipas renditjes së mëposhtme:

1. Kapitulli 2 Dispozitat e përgjithshme, Pika 2.2 Furnizimi, përdorimi dhe menaxhimi i cilësisë së informatave meteorologjike, Rekomandimi 2.2.2, Rekomandimi 2.2.3, Rekomandimi 2.2.4, Rekomandimi 2.2.5, Rekomandimi 2.2.6, Rekomandimi 2.2.7 do të jenë të zbatueshëm si Standard, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
2. Pika 2.3- Njoftimet e nevojshme nga operatorët, Rekomandimi 2.3.4, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
3. Kapitulli 4, Vëzhgimet dhe raportet meteorologjike, Pika 4.1 Stacionet dhe vëzhgimet Meteorologjike aeronautike, Rekomandimi 4.1.6 dhe Rekomandimi 4.1.7 do të jenë të zbatueshme si Standard, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
4. Pika 4.6 Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.6.1 Era mbi tokë, Rekomandimi 4.6.1.2 dhe Rekomandimi 4.6.1.3, do të jenë të zbatueshëm si Standard, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
5. Pika 4.6 Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.6.2- Dukshmëria, Rekomandimi 4.6.2.2 dhe Rekomandimi 4.6.2.3, do të jenë të zbatueshëm si Standard, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
6. Pika 4.6 Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.6.3 Dukshmëria në pistë, Rekomandimi 4.6.3.2, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.

7. Pika 4.6 Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.6.4 Moti i tanishëm, Rekomandimi 4.6.4.2 dhe Rekomandimi 4.6.4.3, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
8. Pika 4.6 Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.6.5 Retë, Rekomandimi 4.6.5.2 dhe Rekomandimi 4.6.5.3 do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
9. Pika 4.6 Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.6.6 Temperatura e ajrit dhe temperatura e pikës së vesës, Rekomandimi 4.6.6.2, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
10. Pika 4.6 Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.6.8 Informatat shitesë, respektivisht Rekomandimi do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
11. Pika 4.7 Raportimi i informatave meteorologjike nga sistemet automatike të vëzhgimit, Rekomandimi 4.7.2 do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
12. Kapitulli 5, Vëzhgimet dhe raportet nga aeroplani, Pika 5.3 Vëzhgimet rutinore në aeroplan-përcaktimi, Rekomandimi 5.3.1 do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
13. Kapitulli 6, Parashikimet, Pika 6.2 Parashikimet e Aerodromit, Rekomandimi 6.2.6, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
14. Pika 6.4 Parashikimet për ngritje, Rekomandimi 6.4.2, Rekomandimi 6.4.3 dhe Rekomandimi 6.4.4, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
15. Kapitulli 7, SIGMET dhe AIRMET, Paralajmërimet për aerodromin dhe Paralajmërimet dhe Alarmet për Ndryshimin e Erës (Wind Shear), Pika 7.3, Paralajmërimet për aerodromin, Rekomandimi 7.3.2 do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
16. Kapitulli 8 Informatat klimatologjike aeronautike, Pika 8.1 Dispozitat e përgjithshme, Rekomandimi 8.1.3, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
17. Pika 8.3 Përmbledhjet klimatologjike të aerodromit, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
18. Kapitulli 9, Shërbimi për operatorë dhe anëtarë të ekuipazhit, Pika 9.2 Njoftimi, konsultimi dhe paraqitja, Rekomandimi 9.2.5, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
19. Pika 9.3 Dokumentacioni i fluturimit, Rekomandimi 9.3.3 do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
20. Kapitulli 10, Informatat për Shërbimet e trafikut ajror, Shërbimet e kërkimshpëtimit dhe Shërbimet e informimit aeronautik, Pika 10.1 Informata për njësitë e Shërbimeve të trafikut ajror, Rekomandimi 10.1.2 do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
21. **Shtojca 2**, Specifikimet teknike të ndërlidhura me Sistemin botëror të parashikimit dhe Shërbimet Meteorologjike, Pika 4, Qendrat e vëzhgimit të vullkaneve, Nën-pika 4.1 Informatat nga Qendrat e vëzhgimit të vullkaneve, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.

22. **Shtojca 3**, Specifikimi teknik lidhur me Vëzhgimet dhe raportet meteorologjike, Pika 1, Dispozitat e përgjithshme lidhur me Vëzhgimet Meteorologjike, Rekomandimi 1.1, Rekomandimi 1.2, Rekomandimi 1.3 dhe Rekomandimi 1.4, do të jenë të zbatueshëm si Standard, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
23. Pika 2, Kriteret e përgjithshme të lidhur me Raportet Meteorologjike, Nën-pika 2.1 Format i Raporteve Meteorologjike, Rekomandimi 2.1.3, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
24. Pika 2, Kriteret e përgjithshme të lidhur me Raportet Meteorologjike, Nën-pika 2.3, Kriteret për lëshimin e raporteve lokale speciale dhe SPECI, Rekomandimi 2.3.3, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
25. Pika 3, Shpërndarja e raporteve Meteorologjike, Nën-pika 3.1 METAR dhe SPECI, Rekomandimi 3.1.4, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
26. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.1 Era mbi tokë, Rekomandimi 4.1.1 dhe Rekomandimi 4.1.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
27. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.1.2 Paraqitja, Rekomandimi 4.1.2.2, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
28. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.1.3 Nxjerrja e mesatares, Rekomandimi 4.1.3.2, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
29. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.1.4 Saktësia e matjes, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
30. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.2 Dukshmëria, Rekomandimi 4.2.1.1 dhe Rekomandimi 4.2.1.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
31. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.2.2 Paraqitja, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
32. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.2.3 Nxjerrja e mesatares, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
33. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.2.4 Raportimi, Rekomandimi 4.2.4.3 dhe Rekomandimi 4.2.4.4, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
34. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.3 Dukshmëria në pistë, Rekomandimi 4.3.1.1 dhe Rekomandimi 4.3.1.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
35. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.3.2 Sistemet me instrumente, Rekomandimi 4.3.2.2, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.

36. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.3.3 Paraqitja, Rekomandimi 4.3.3.2, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
37. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.3.5 Intensiteti i dritave të pistës, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
38. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.3.6 Raportimi, Rekomandimi 4.3.6.2 dhe Rekomandimi 4.3.6.5 dhe Rekomandimi 4.3.6.6, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
39. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.4 Moti i tanishëm, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
40. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.4.2 Raportimi, Rekomandimi 4.4.2.3, Rekomandimi 4.4.2.4, Rekomandimi 4.4.2.6, dhe Rekomandimi 4.4.2.7, do të jenë të zbatueshme si Standarde, pa ndryshim ndaj tekstit.
41. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.5 Retë, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
42. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.5.2 Paraqitja, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
43. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.5.4 Raportimi, Rekomandimi 4.5.4.2, Rekomandimi 4.5.4.3 dhe Rekomandimi 4.5.4.5, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
44. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.6 Temperatura e ajrit dhe temperatura e pikës së vesës, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
45. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.7 Shtypja atmosferike, Niveli referencë 4.7.2, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
46. Pika 4, Vëzhgimi dhe raportimi i elementeve meteorologjike, Nën-pika 4.8 Informatat shtesë, Rekomandimi 4.8.1.1, Rekomandimi 4.8.1.2, Rekomandimi 4.8.1.3,, Rekomandimi 4.8.1.4, Rekomandimi 4.8.1.5, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
47. **Shtojca 4**, Specifikimet teknike të ndërlidhura me Vëzhgimet dhe raportet nga aeroplanët, Pika 3, Shkëmbimi i raporteve nga ajri, Nën-pika, 3.3 Shpërndarja shtesë e raporteve nga ajri, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
48. Pika 4, Dispozitat specifike të ndërlidhura me Raportimin e Ndryshimit të Erës (Wind Shear) dhe të hirit vullkanik, Nën-pika 4.1 Raportimi i Ndryshimit të Erës (Wind Shear), Rekomandimi 4.1.1 dhe Rekomandimi 4.1.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.

49. **Shtojca 5**, Specifikimet teknike të ndërlidhura me Parashikimet, Pika 1, Kriteret e ndërlidhura me TAF, Nën-pika 1.1 Format i TAF, Rekomandimi 1.1.2, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
50. Pika 1, Kriteret e ndërlidhura me TAF, Nën-pika 1.2 Përfshirja e elementeve meteorologjike në TAF, Nën-pika 1.2.2 Dukshmëria, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
51. Pika 1, Kriteret e ndërlidhura me TAF, Nën-pika 1.2 Përfshirja e elementeve meteorologjike në TAF, Nën-pika 1.2.4 Retë, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
52. Pika 1, Kriteret e ndërlidhura me TAF, Nën-pika 1.2 Përfshirja e elementeve meteorologjike në TAF, Nën-pika 1.2.5 Temperatura, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
53. Pika 1, Kriteret e ndërlidhura me TAF, Nën-pika 1.3 Përdorimi i grupeve të ndryshimit, Rekomandimi 1.3.2, Rekomandimi 1.3.3, Rekomandimi 1.3.4, Rekomandimi 1.3.5 dhe Rekomandimi 1.3.6, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
54. Pika 1, Kriteret e ndërlidhura me TAF, Nën-pika 1.4 Përdorimi i grupeve të probabilitetit, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
55. Pika 1, Kriteret e ndërlidhura me TAF, Nën-pika 1.5 Numrat e ndryshimit dhe grupet e probabilitetit, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
56. Pika 3, Kriteret e ndërlidhura me parashikimet për ngritje, Nën-pika 3.1 Format i parashikimeve për ngritje, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
57. Pika 3, Kriteret e ndërlidhura me parashikimet për ngritje, Nën-pika 3.2 Ndryshimet ndaj parashikimeve për ngritje, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
58. **Shtojca 6**, Specifikimet teknike të ndërlidhura me Informatat SIGMET dhe AIRMET, Paralajmërimet për aerodromin dhe Paralajmërimet dhe Alarmet për Ndryshimin e Erës (Wind Shear), Pika 1, Specifikimet e ndërlidhura me Informatat SIGMET, Nën-pika 1.1 Format i mesazheve SIGMET, Rekomandimi 1.1.6 dhe Rekomandimi 1.17, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
59. Pika 2, Specifikimet e ndërlidhura me Informatat AIRMET, Nën-pika 2.2 Shpërndarja e mesazheve AIRMET, Rekomandimi 2.2.1 dhe Rekomandimi 2.2.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
60. Pika 3, Specifikimet e ndërlidhura me Raportet speciale nga ajri, Rekomandimi 3.1 dhe Rekomandimi 3.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
61. Pika 4, Kriteret e detajuara të ndërlidhura me mesazhet SIGMET dhe AIRMET dhe Raportet speciale nga ajri (Uplink), Nën-pika 4.1, Identifikimi i rajonit të informimit gjatë fluturimit, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
62. Pika 4, Kriteret e detajuara të ndërlidhura me mesazhet SIGMET dhe AIRMET dhe Raportet speciale nga ajri (Uplink), Nën-pika 4.2 Kriteret e ndërlidhura

me fenomenet e përfshira në mesazhet SIGMET dhe AIRMET dhe Raportet speciale nga ajri (Uplink), Rekomandimi 4.2.1, Rekomandimi 4.2.2, Rekomandimi 4.2.3, Rekomandimi 4.2.4, Rekomandimi 4.2.5, Rekomandimi 4.2.7 dhe Rekomandimi 4.2.8, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.

63. Pika 5, Specifikimet e ndërlidhura me Paralajmërimet për aerodromin, Nën-pika 5.1, Formatit dhe shpërndarja e Paralajmërimeve për aerodrom, Rekomandimi 5.1.3 dhe Rekomandimi 5.1.4, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
64. Pika 5, Specifikimet e ndërlidhura me Paralajmërimet për aerodromin, Nën-pika 5.2 Kriteret kuantitative për Paralajmërimet për aerodromin, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
65. **Shtojca 7**, Specifikimi teknik i ndërlidhur me Informatat klimatologjike aeronautike, Pika 1, Procedimi i Informatave klimatologjike aeronautike, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
66. Pika 2, Shpërndarja e Informatave klimatologjike aeronautike, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
67. Pika 3, Përmbajtja e informatave klimatologjike aeronautike, Nën-pika 3.1 Tabelat klimatologjike për aerodrome, Rekomandimi 3.1.1, Rekomandimi 3.1.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
68. Pika 3, Përmbajtja e informatave klimatologjike aeronautike, Nën-pika 3.2 Përmbledhjet klimatologjike të aerodromit, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
69. **Shtojca 8**, Specifikimi teknik i ndërlidhur me Shërbim për operatorët dhe anëtarët e ekuipazhit, Pika 1, Mjetet e furnizimit dhe Formatit i informatave Meteorologjike, Rekomandimi 1.3, do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
70. Pika 2, Specifikimi i ndërlidhur me Informatat për planifikim para fluturimit dhe ri-planifikim gjatë fluturimit, Nën-pika 2.3 Nevojat specifike të operimeve të helikopterëve, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
71. Pika 3, Specifikimet e ndërlidhura me Njoftim dhe konsultim, Nën-pika 3.1 Informatat që duhet të paraqiten, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
72. Pika 4, Specifikimet e ndërlidhura me Dokumentacioni i fluturimit, Nën-pika 4.1 Paraqitja e informatave, Rekomandimi 4.1.3 dhe Rekomandimi 4.1.4, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
73. Pika 4, Specifikimet e ndërlidhura me Dokumentacioni i fluturimit, Nën-pika 4.2 Skicat në Dokumentacion të fluturimit, Rekomandimi 4.2.1.1, Rekomandimi 4.2.1.3, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
74. Pika 4, Specifikimet e ndërlidhura me Dokumentacionin e fluturimit, Nën-pika 4.3 Specifikimet e ndërlidhura me fluturimet në nivel të ulët, Nën-pika

- 4.3.1, dhe Nën-pika 4.3.2, Rekomandimet përkatëse, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
75. Pika 5, Specifikimet e ndërlidhura me Sistemet e automatizuara për informim para fluturimit për njoftim, konsultim, planifikim të fluturimit dhe Dokumentacion të fluturimit, Nën-pika 5.2 Specifikat e detajuara të sistemeve, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
76. Pika 6, Specifikimet e ndërlidhura me Informatat për fluturaket në fluturim, Nën-pika 6.1, Furnizimi i informatave të kërkuara nga fluturakja gjatë fluturimit, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
77. Pika 6, Specifikimet e ndërlidhura me Informatat për fluturaket gjatë fluturimit, Nën-pika 6.2, Informatat për planifikim gjatë fluturimit nga operatori, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
78. **Shtojca 9**, Specifikimet teknike të ndërlidhura me Informatat për Shërbimet e trafikut ajror, Shërbimet e kërkim-shpëtimit dhe Shërbimet e informimit aeronautik, Pika 1, Informatat që duhet t'i ofrohen njësive të Shërbimeve të trafikut ajror, Nën-pika 1.5 Format i informatave, Rekomandimi 1.5.1 dhe Rekomandimi 1.5.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
79. Pika 2, Informatat që duhet të ofrohen për njësitë e Shërbimeve të kërkim-shpëtimit, nën-pika 2.2 Informatat që ofrohen pas kërkesës, Rekomandimi 2.2.1, Rekomandimi 2.2.2 dhe Rekomandimi 2.2.3, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
80. **Shtojca 10**, Specifikimet teknike të ndërlidhura me Kërkesat si dhe përdorimi i Komunikimeve, Pika 1, Kërkesat specifike për Komunikime, Nën-pika 1.1, Periudhat transitore të nevojshme për informata meteorologjike, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
81. Pika 1, Kërkesat specifike për Komunikime, Nën-pika 1.2 Të dhëna të pikës së rrjetit të të dhënave për Shërbimin e trafikut ajror dhe operatorët, Rekomandimi 1.2.1 dhe Rekomandimi 1.2.2, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.
82. Pika 2, Përdorimi i komunikimeve të shërbimit fiks aeronautik dhe i Internetit publik, Nën-pika 2.1.1 përbërja e buletineve, Nën-pika 2.1.2 Periudhat e lëshimit të buletineve, Rekomandimi përkatës do të jetë i zbatueshëm si Standard, pa ndryshim ndaj tekstit.
83. Pika 2, Përdorimi i komunikimeve të shërbimit fiks aeronautik dhe i Internetit publik, Nën-pika 2.2 Produktet e sistemit botëror të parashikimit, Nën-pika 2.2.1, Nën-pika 2.2.2 dhe Nën-pika 2.2.3, Rekomandimet përkatëse, do të jenë të zbatueshme si Standarde, respektivisht, pa ndryshim ndaj tekstit.

4.2 Dallimet e listuara në paragrafin 1 të këtij Neni do të publikohen në Publikimin e Informatave Aeronautike (PIA), njëzet e tetë (28) ditë pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

Neni 5
Disponueshmëria

SPR-të e Aneksit 3, siç është specifikuar në nenin 1, paragrafi 2, në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje, i bashkëngjiten kësaj Rregulloreje si Shtojca 1.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 18 shkurt 2014.

Prishtinë, 3 shkurt 2014.

Dritan Gjonbalaj
Drejtori i Përgjithshëm